

The image is a book cover featuring a sunset over a body of water. The sun is low on the horizon, creating a bright, shimmering path of light across the water's surface. In the foreground, a dark silhouette of a person is sitting on a rock, looking out towards the sunset. The sky is filled with warm, orange and yellow hues, and the water reflects these colors. The overall mood is contemplative and serene.

A ekziston Perëndia...

Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Tiranë, 2005

TIMOTHEOS K. KILIFIS

A EKZISTON PERËNDIA?

Përshtati:
Jorgo Papadhopulli

**Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë
Tiranë, 2005**

A ekziston Perëndia?

Një nga ateistët e sotëm thotë: "Lërja idenë e Zotit klerikëve dhe maceve qorre, ose urithëve që nuk shohin".

Dikush tjetër pyet: Duke hedhur vështrimin nga shkenca, teknologjia ose zhvillimi social, a mund të besojmë akoma në ekzistencën e Perëndisë? Ky mendim është anakronizëm, naivitet apo padituri?

Të arsimuarit dhe të rinjtë, për sa i përket një koncepti të tillë, kanë tendencë të priren nga liria. Ata besojnë vetëm në zhvillimin e shkencës dhe kulturave.

Çështja për ekzistencën e Perëndisë është problem shumë serioz, që ka okupuar mendjen e shumë njerëzve. Ne duhet ta shohim këtë çështje objektivisht dhe realisht.

Në radhë të parë theksojmë se kjo temë nuk i përket vetëm së sotmes, përkundrazi ajo është shumë e vjetër. Shumë njerëz kanë folur rreth saj, duke u munduar ta analizojnë në thellësi.

Ata janë përpjekur t'i përgjigjen pyetjeve të mëposhtme:

A ekziston Perëndia? Nëse Ai ekziston, kush e krijoi Atë? Kush dhe çfarë është Perëndia? Nëse Ai nuk ekziston, përse flitet për qenien e Tij? Kush e drejton

universin e pafund? Mos vallë universi u krijua nga vetvetja apo u krijua rastësisht, pa ndonjë kuptim dhe pa ndonjë qëllim? Mundet që rastësia, fati ta shpjegojë misterin e universit dhe aq më tepër misterin e qenies njerëzore? Përfundimisht çfarë është rastësia, fati? A janë të përbërë nga ndonjë substancë?

Ndryshe pyetja mund të ngrihet: Ekziston Zoti apo rastësia, ose fati?

Përgjigjja ndaj pyetjes së fundit për sa i përket pjesëmarrjes së Zotit në krijim ose krijimi i botës erdhi si rezultat i rastësisë, pa ndonjë shkak, është një çështje thjesht personale. Ajo vjen si rezultat i besimit, i cili nuk është diçka objektive dhe nuk mund të shqyrtohet ose shpjegohet në kuadrin e një teorie shkencore. Ajo varet nga mënyra personale e jetesës. Besimi i secilit prej nesh reflektohet në sjelljen e tij.

Besimi tek Perëndia është një mister. Ai është diçka që shfaqet si rezultat i konfliktit me vetveten, racionalen dhe me botën përreth. Me anë të kësaj sprove me mendjen, po përpiqemi të futemi më thellë në shpjegimin e kësaj çështjeje, duke mos u nisur nga këndvështrimi i një besimtari orthodhoks, por duke e parë atë në këndvështrime të ndryshme. Kjo bëhet për të ndihmuar të gjithë ata njerëz që seriozisht dhe sinqerisht duan të merren dhe t'i përgjigjen kësaj çështjeje kaq të rëndësishme – ekzistencës së Perëndisë. Prandaj do të ishte me interes të shikonim këtë çështje nga këndvështrime dhe burime të ndryshme. Ky dialog do të na çojë në zbulimin e së vërtetës. Monologu nuk është një instrument i së vërtetës.

Pyetja e madhe

A ekziston Zoti?

Kjo është një pyetje, përgjigjja e së cilës varet nga mënyra e jetës që ka zgjedhur çdo individ.

Një njeri e pranon Perëndinë si Krijues dhe të Gjithëpushtetshëm të univeresit, ndërsa një tjetër thotë se kjo gjë ka ndodhur nga rastësia, fati dhe do të vazhdojë të ndodhë përsëri. I pari ka një qendër referimi në jetën e tij, tjetri nuk ka asgjë.

Të parët gjejnë një qëllim dhe kuptim për jetën, që shkon deri në pafundësi. Tjetri e kufizon kohën e tij deri në një limit të caktuar dhe në një ko incidencë aksidentale. Njëri bazon besimin e tij mbi një forcë “metafizike” ndërsa tjetri mbi një qenie fizike, kryesisht njerëzore.

Besimtarët dhe jobesimtarët janë shumë të ndryshëm si në orientim ashtu dhe në këndvështrim. Të parët zbulojnë në krijimin shpirtëror dhe material një urtësi infinite, fuqinë dhe dashurinë e Perëndisë – Krijuesit – dhe thërrasin nga thellësia e zemrës: “Sa të mëdha janë veprat e tua, o Zot, të gjitha i ke krijuar me urtësi”. Të dytët besojnë se të gjitha janë krijuar nga vetvetja si rezultat i një ko incidencë aksidentale.

Materialistët e konsiderojnë materien si qenie të vetme. Nuk ekziston asgjë jashtë saj. Ata thonë se koncepti i Perëndisë si Krijues dhe Mbret, është si rezultat i frikës, injorancës, nevojës apo interesit personal. "Feja është një përrallë". Materialistët deklarojnë se manifestimi psikologjik i njerëzve dhe i jetës shpirtërore në përgjithësi, në të cilën përfshihet dhe besimi, nuk është përmes ndonjë perëndie ose një shpirti të krijuar nga Perëndia, por nëpërmjet një procesi elektromekanik të trurit - në vetë natyrën. Ata theksojnë ekzistencën e "antropomorfizmit", i cili është prezent në më të shumtat e besimeve moderne. Kur ata adhurojnë perënditë, i atribuojnë atyre forma me karakteristika njerëzore, mendjemprehtësinë dhe dashurinë. Materialistët thonë se fetë janë krijime njerëzore, të cilat tërheqin kryesisht njerëzit naivë. Përgjithësisht njerëzit inteligjentë nuk besojnë tek Perëndia, sepse për ta Zoti nuk ekziston. Materialistët besojnë se shpikës të ndryshëm krijuan idenë për Perëndinë në mënyrë që të mashtronin masat e njerëzve.

Ja se çfarë thonë disa prej tyre:

Marks (1817-1883): "Kapitalistët shpikën idenë e Perëndisë për të shfrytëzuar masat." (Ky e huazoi teorinë e tij nga Fojerbahu).

Frojdi (1856-1939) konsideron se besimi në Perëndinë dhe në mënyrë më të specifikuar, feja në vetvete, është një mashtrim i instiktit seksual. Ai deklaroi se besimi është një kompleks Edipian

(marrëdhënie seksuale dhe ngatërrim gjakrash brenda familjes) ose një koklavitje e besimit, etikës dhe shoqërsë, ose një arti të dalë nga ky kompleks dhe kjo përzierje.

Sarti (1905-1980): " Unë nuk besoj në Zotin, sepse koncepti dhe ideja e "qenies", e cila e ka fillimin nga vetvetja, është ideja për Perëdinë, është bërë kufizim i lirisë së njeriut". Diku tjetër po Sarti shkroi të kundërtën, ai shfaqet sikur kërkon Perëdinë, por e kërkon atë jo më sipas mendimit racional, por duke menduar negativisht. Duke pyetur çfarë ekziston pas logjikës?

Foerbah (1804-1872), babai i teorisë materialiste. Me qëllim që të lironte njeriun nga pozicioni inferior në të cilin e vendos besimi në një qenie më të lartë se vetja e tij, ai mbështet mendimin se: "Perëndia nuk ekziston - njeriu është thjesht ajo çfarë ai ha (konsumon)".

Hegel (1834-1919). Keqinterpretonte teorinë darviniane dhe nga këndvështrimi i filozofisë hiliste ai hedh poshtë ekzistencën e Zotit dhe pranon "Lindjen automatike" - (Automatic Genesis).

Bukner (1824-1899), materialist i madh. Ai shkroi: "Bota është rezultat i lëndës (substancës) dhe fuqisë, është pa fillim, pa shkak dhe e përhershme".

Materialistët që përmendëm më lart si dhe këta të sotmit, hedhin poshtë idenë e ekzistencës së Perëndisë, duke pasur si bazë punën dhe mendimin e materialistëve të lashtësisë: Demokritit, Epikurit, Protagorës, Heraklitit, Lukretit, në mënyrë indirekte Zinonit dhe filozofëve të tjerë stoikë.

Demokriti (460-371 para Krishtit) shkruante: "Bota lindi si rezultat i atomeve. Këto atome nuk kanë fillim dhe janë të pastra, të paprishura dhe pafund. Lëvizja e tyre është e pafund. Shpirti gjithashtu është një kompozim i atomeve, të cilat e kanë rrethuar ose gjenden rrotull tij. Atomet janë fillimi i çdo gjëje".

Epikuri (342-271 para Krishtit). Bazuar në teorinë e Demokritit mbron mendimin se bota është krijuar nga një masë kaotike atomesh. Këto atome ishin vërtitur rreth e rrotull rastësisht, pa ndonjë plan dhe kështu bota erdhi në ekzistencë. Shpirti është bërë si rezultat i këtyre atomeve. Pas vdekjes shpirti zbutet dhe kthehet përsëri në atome. Çdo gjë varet nga shqisat tona.

Leuçipi (shekulli V para Krishtit). Ishte mësuesi i Demokritit dhe i influencuar shumë nga panteizmi orfeik. Ai deklaroi se lënda është dielli i lindjes së botës.

Lukreti (95-55 para Krishtit). Poet romak, materialist ekstremist në "De rerum natura" (për natyrën e gjërave). Ai përsëriti teorinë e Epikurit dhe ka një qëndrim sarkastik pothuajse ndaj gjithë filozofëve. Lukreti përpiqet të hedhë poshtë besimin e tyre me argumente të mundshme. Niçe ishte gjithashtu i influencuar nga Lukreti.

Protagoras (485-415 para Krishtit). Themelues i Sofizmit dhe ndjekës i Heraklitit në teorinë e tij mbi "Qenien" mësonte se "masa e gjithë qenieve është njeriu". Duke pasur parasysh perënditë, shkruante: "Unë nuk di asgjë dhe kjo lidhet me faktin se dy gjëra fshehin mendimin tim: obskurantizmi i çështjes si dhe guximi i jetës sime.

Herakliti (540-480 para Krishtit). Besonte se bota nuk është krijuar as nga Zoti dhe as nga njeriu, por si fillim ishte "Fjala"(Logos), e cila zotëronte shumë dimensione përveç kuptimit të përgjithshëm që kanë "fjalët e folura". Natyra parapëlqen që të fshihet pas Logos - it dhe kjo e fundit u zbulua sipas rregullit të brendshëm të universit. Nga njëra anë, Herakliti pranoi natyrën metafizike të Logos - it dhe e konsideroi Atë si fillim të çdo gjëje në botë. Ai ishte i pari që kultivoi konceptin e Logos - it, i cili më vonë i dha shtysë formimit të mendimit njerëzor, dhe sidomos mendimit të krishterë. Veçanërisht në Ungjillin sipas Joanit, i cili fillon me frazën "Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi", nuk ekziston asnjë mendim teologjik, i cili nuk ka lidhje me Logos - in. Natyrisht mendimi dhe e vërteta që: " Fjala u bë mish dhe banon ndër ne", është zbulim i krishterë. Filozofët e lashtësisë u morën dhe e diskutuan konceptin e Logos - it në mënyrë abstrakte. Krishterimi i dha Logos- it bazë ontologjike (të qenësishme). Për krishterimin Logos - i është "qenia e vërtetë", Zoti. Herakliti, pa qenë i vetëdijshëm dhe pa e ditur, ishte një besimtar, duke na përgatitur në këtë mënyrë për të pranuar "Logos - in e vërtetë".

Zenoni (336-241 para Krishtit). Themeluesi i Stoicizmit dhe parapërgatitësi i gjithë filozofëve stoikë, ishte panteist. Shopenhauzeri shkruan se panteizmi është një "ateizëm xhentil", ose së paku hyrje për në ateizëm. Panteizmi nuk pranon një perëndi personal dhe trashendent. Për ta, Perëndia është gjithçka.

Disa studiues konsiderojnë Pitagorën dhe Anaksagorën si materialistë, sepse ata kishin tendencë për të përkrahur panteizmin. Por po të thellohemi në veprën e tyre, kuptojmë menjëherë se një mendim i tillë nuk është i drejtë.

Gjithashtu dhe fetë mistike të Greqisë së lashtë si dhe popujve të tjerë të hershëm ishin bazuar në kërkime, njohuri dhe kontakte të thella me Hyjninë.

Pak a shumë teoritë e shkencëtarëve dhe filozofëve të tjerë ateistë janë të ngjashme. Le të ndalemi tani tek mendimtarë të tjerë të shquar nga degë të ndryshme të shkencës dhe filozofisë, të cilët në një farë mënyre ishin njerëzit që vunë gurin themeltar në shkencë, filozofi dhe formimin social të njerëzimit.

Kush pranon ekzistencën e Perëndisë dhe si?

Le të fillojmë me filozofët dhe shkencëtarët e lashtë grekë, të cilët ishin të parët që hodhën bazat e metodat e dijes dhe shkencës. Ata u përpoqën të zbulojnë dhe të unifikojnë teorinë rreth krijimit të universit.

Thalis Milisiani ndjente se uji paraqiste Fillimin e krijimit, të cilin e konsideronte "jetë" dhe besonte se "çdo gjë ishte e mbushur nga zotat" dhe "bota ishte krijesë (poemë) e Perëndisë".

Anaksimandri – pafundësinë

Anaksimeni – ajrin

Anaksagora- mendjen

Empedokliti - zjarrin, tokën, ajrin dhe ujin – me fjalë të tjera këto katër elemente ai i konsideronte Fillim të botës.

Herakliti – Fjala (Logos).

Kjo është arsyeja përse Aristoteli shkruante që filozofët përpara Sokratit morën një element të vetëm dhe i atribuuan atij kualitete hyjnore dhe besonin se këta "elementë janë nga natyra të padukshëm, pa fillim dhe të pushtetshëm mbi çdo gjë". Ky "tundim" ishte shumë domethënës për atë kohë, ishte përpjekja e parë për shpjegimin metafizik të universit.

Në Greqinë e lashtë ku u formuan dhe shkencat, elementët "metafizikë" ishin elementët themelorë.

Ndoshta dhe vetë Demokriti, i cili konsiderohej si baba i materializmit, ia atribuonte metafizikën "atomeve", me fjalë të tjera elementeve të tillë, të cilët s'mund të ndahen më tej.

Ksenofani (shek 6 para Krishtit), mësues i Parmenidhit shkruante: "Midis perëndive dhe njerëzve është një Perëndi që është më i madhi". Dhe këtë gjë e thoshte për t'iu kundërvënë ateizmit dhe "antropomorfizmit".

Filozofët Orfea dhe Pitagora kishin në teorinë e tyre shumë nocione fetare dhe metafizike. Aristoteli i quante ata "Teologë".

Pitagora (580 – 420 para Krishtit), ishte filozofi dhe matematicieni më i madh në botë dhe udhëheqësi i filozofëve pitagorianë. Ai pohon: "Midis Olimpit dhe perëndive të nëndheshme" ai dallon një Perëndi Dominante, perëndinë e perëndive. "Ai është Zot dhe ai ka pushtet mbi gjithçka. Ai është babai i të gjithave. Ai është mendja dhe shpirti i gjithçkaje".

I ashtuquajhuri panteizëm i Pitagorës është shumë larg nga panteizmi i vërtetë. Ai besonte fuqimisht në një Perëndi, sundues dhe mbajtës i harmonisë në botë.

Parmenidhi (rreth 500 para Krishtit). Ai deklaronte që "çdo gjë e ka origjinën nga "Qenia Hyjnore" Ajo është fillimi dhe mban gjithçka në botë".

Plato (421-341 para Krishtit), nxënës i Sokratit, i cili, megjithëse mendimi dominues i kohës ishte

“Politeizmi”, pohonte se Perëndia është “qenia e vërtetë”, “përsosmëria”, “i palinduri”, “i patretshmi” “i përjetshmi”. Ai nënvizonte: “Perëndia është gjithmonë një gjeometër”. Me fjalë të tjera ai thoshte se Perëndia krijon me mendjen e Tij të bukur. Natyrisht Perëndia e Platos është zakonisht një perëndi “dekorativ”, ndërsa e të Krishterëve jo vetëm “dekorativ”, por krijuesi i gjithë botës. Filozofët e vjetër grekë nuk mund të kuptonin se si krijimi vjen si rezultat i diçkaje që nuk ekziston, që është “jashtë gjithçkaje”. Edhe e vërteta e Ungjillit akoma nuk ishte zbuluar. Ata nuk mund të kuptonin fuqinë e Logosit, i cili krijon nga hiçi.

Aristoteli (384-322 para Krishtit). Filloi me idenë e lëvizjes dhe tha se lëvizja e parë në botë duhet të ketë filluar nga një qenie e palëvizshme. Fillimi është Perëndia “Ai që vë në lëvizje i pari është i palëvizur”. Dhe në “Metafizikën” ai shkroi se “Perëndia ekziston përpara krijimit. Perëndia është i përjetshëm, pa masë, një shpirt i pastër”. Ai e quajti atë “Perëndi i të Lartit” që sundon mbi gjithçka.

Diku tjetër për sa i përket lëvizjes ai shprehet me rezonancën e mëposhtme: “Çdo gjë në botë lëviz me një qëllim dhe një urdhër. Kush e vendos lëvizjen e duhur që nban botën në një regull të caktuar? Pa dyshim, Perëndia. Ai është shkaku i lëvizjes. Qeniet, meqenëse janë krijesa, nuk janë në gjendje të shpjegojnë qëllimin e lëvizjes së tyre. Kjo lëvizje është komanduar nga Truri Suprem i Perëndisë, sepse Ai “është fillimi i gjithçkaje.”

Dekarti (1596-1650). Fizikant, matematicien dhe filozof i madh. Ai shkroi se Perëndia është krijuesi i universit.

Paskali (1623-1662). Mendimtari i fenomeneve matematike dhe filozofike. Ai deklaronte se pa Krishtin, përmes të cilit ishte krijuar gjithçka, çdo gjë është bosh.

Ainshtajni pohonte se shkenca i zbehu atij besimin tek Perëndia.

Mirë është që të ndalojmë në këtë pikë dhe mos përmëdim ç'kanë thënë udhëheqës dhe mendimtarë të tjerë besimtarë si Njutoni, Kepleri, Markoni, Koperniku, Mendeli, Galileo, Planku, Haizerbahu, Von Brahun, Bahu, Betoveni, Dostojevski etj., sepse lexuesit mund të lodhen. Por ka pasur raste që në kohën e tyre ata e kanë mbrojtur të vetëm idenë e ekzistencës së Perëndisë. Sokrati dhe Galileo mbështetën të vërtetën edhe duke qenë të vetëm. E vërteta nuk ka nevojë për reklama të pandershme dhe ekstravagante. Kjo është arsyeja që për hir të historisë dhe të vërtetës që përmendëm më lart dalin dy kampe të kundërta mendimesh për sa i përket temës sonë.

Këndvështrimi

Pasi kemi folur për dy grupe me mendime të kundërta, mund të themi se për sa i përket ekzistencës së Perëndisë, është provuar se brenda historisë njerëzore janë aktualisht dy grupe opozitare.

Ekziston gjithashtu dhe një grup i tretë, të cilin nuk e preokupon fare kjo temë. Ky grup jeton pa ndonjë shqetësim, pa ndonjë dhimbje koke që shkaktojnë mendime të tilla. Qëndrimi i tyre nuk mund të konsiderohet shumë i lavdërueshëm për arsye se vetëm kafshët jetojnë pa u shqetësuar. Realiteti tregon se shumë njerëz janë të preokupuar dhe duan të mësojnë më shumë për sa i përket kësaj teme. Siç ka shkruar dhe besimtari Gëte: "Historia kurrë nuk e ka përfunduar luftën midis besimit dhe mosbesimit".

Çdo njeri i përket, ose më mirë të themi është pozicionuar automatikisht në një nga këto tri kategori që përmendëm më lart, kjo varet nga gjendja e tij shpirtërore ose nga mënyra e jetesës. Mënyra se si ne jetojmë, stili i jetës, zbulon dhe besimin tonë. Ajo zbulon kualitetin e secilit, duke "vendosur veten" në njëren prej këtyre kategorive.

Në këtë moment le të citojmë diçka nga Pitagora, fjalët e të cilit gjatë shekujve janë përmendur nga njerëz të ndryshëm, kryesisht materialistë: "Unë besoj tek njeriu dhe nuk më intereson ku është, apo nuk ekziston fare Zoti. Për mua vlera e njeriut mjafton. Me anë të saj mund të vlerësoj dhe të mas çdo gjë në jetë".

Unë do të desha të ngre vetëm një pyetje: "A do të mundte njeriu nga vetvetja të kuptonte gjithë qenien njerëzore?"

Dy aspektet

Le të shohim tani dy aspekte, të cilat ndoshta do të jenë më të rëndësishme për të kuptuar temën tonë.

I pari është se në realitet nuk ekzistojnë ateistë. Sepse mund të ketë momente kur dhe ateistët "më të mëdhej" spekulojnë. Pyetja që i torturon ata është: "Mos vallë Perëndia ekziston?". Kjo pyetje vjen gjithmonë në mendjet, shkrimet dhe jetën e tyre.

Kur dikush studion jetën e tyre, kupton menjëherë se ata janë ateistë "vetëm në teori". Në thelbin e qenies së tyre janë fshehur shumë pyetje për sa i përket Perëndisë. Kjo ndodh sepse ata në vetvete janë "shëmbëlltyrë" e Perëndisë dhe kanë brenda ekzistencës së tyre "shëmbëlltyrën dhe ngjashmërinë me Perëndinë". Kjo është arsyeja që kanë dyshime.

Aleks Kamus "ateist" në një nga veprat e tij shkruan: "Unë nuk besoj në Perëndinë, por nuk jam një ateist". Diku tjetër ai shton: "nëse ideja e ndryshimit është e spikatur, atëherë unë po drejtohem drejt një errësire të plotë. Kjo do të thotë një liri e tmerrshme e të verbrit".

Niçe në veprën e tij "ateiste" me titull "Zarathustra" (shkruar më 1887), indinjoi botën duke thënë: "Universi ekziston si rezultat i vetë Përëdisë".

“Zarathustra” në një tjetër pasazh thotë: “O zoti im i panjohur! Udhëto rreth tokës dhe shiko ku janë dhimbjet, brengat, hidhërimet dhe e ardhmja ime”. Niçe është përfaqësuesi më tipik i “ateistit”, i cili me ateizmin e tij kërkon me pasion që të gjejë Perëndinë.

Sarti, siç përmenda më parë, midis mendimeve të tij kontradiktore për Perëndinë, shkruan: “Unë nuk mund ta dëgjoj dot më zërin e (Perëndisë)” dhe e pyet Atë: “Përderisa njeriu është i shqetësuar për çka ndodh rreth tij, ke vdekur Ti vërtet për njerëzit? Po apo jo? Shiko sa vuajnë njerëzit, mos vallë je shurdhuar?” Ai na kujton Davidin që thotë: “Pse po flini, o Zot? Ne jemi të humbur!”

Shembuj të tillë ka me mijëra, sepse shumë nga veprat e “ateistëve” kanë të fshehur brenda tyre më shumë perëndi sesa Perëndia e teologjisë “Akademike”.

Aspekti i dytë lidhet me faktin se shumë ateistë nuk do të ishin të tillë, nëse do t’u zbulohet Perëndia i Vërtetë. Nëse ata vetë do të takonin Perëndinë e Vërtetë! Fatkeqësisht ata takohen me perëndinë e gënjeshtërt.

Perëndia i harruar

Prezantimi korrekt i Perëndisë së vërtetë në historinë njerëzore, është fatkeqësisht një përjashtim.

Zakonisht, me dashje apo pa dashje, në fetë zyrtare ai është prezantuar si një Perëndi i frikshëm, një shtypës Hyjnor, pagan, sadist, nervoz, fatalist etj. Ose si një shkollar, i ftohtë, jo i lidhur me jetën dhe të vërtetën. Një Perëndi, shfrytëzues i masave. Natyrisht, një Perëndi i dyzuar nuk ekziston realisht. Ai ishte hartuar e shpikur dhe vazhdon të hartohet dhe shpiket nga njerëz të shtrembër dhe jonormalë, që vuajnë nga sëmundje psikike. Ata janë tinzarë ose djallëzorë.

Njerëz "mendjemprehtë", të cilët në çdo moment ofendohen nga paraqitja e të vërtetës së Perëndisë. Këta njerëz adhurojnë egot e tyre, paratë, krijimin në vend të vetë Krijuesit, krijimin në vend të Perëndisë së Vërtetë. Por, kush është Perëndia i Vërtetë?

Perëndia i vërtetë

Perëndia i vërtetë nuk ka asnjë lidhje me “perënditë”, të cilat kanë krijuar tipe të ndryshme orthologistësh, pietistësh dhe adhurues idhujsh.

Perëndia i vërtetë, ashtu si në shumë raste do ta theksojmë me forcë, është i mbushur me dashuri, drejtësi dhe liri.

Ai është Perëndia, i cili ndodhet në kuptimet dhe interpretimet më të thella të Shkrimit dhe Traditës së Shenjtë. Ai është Perëndia që përqafton dhe vazhdon të përqaftojë qenien njerëzore dhe e lartëson atë në altarin e sakrificës. Ai është Perëndia, i cili çliroi qenien njerëzore nga skllavëria. Ai është Perëndia që u dha njerëzve arsyetimin dhe njohuritë shkencore për t’i zhvilluar ndër shekuj dhe për të shkuar më tej, sepse arsyetimi dhe njohja janë mjetet e tij të thjeshta.

Ai është Perëndia, i cili ka kapërcyer fanatizmin, zakonet fetare, fetarizmat dhe utilitarizmin. Ai është Perëndia, i cili u përgjigjet të gjitha kërkesave dhe thirrjeve të qenies njerëzore. Ai është personi që përqafton qenien njerëzore në të gjitha aspektet dhe dimensionet e jetës. Ai është Perëndia, i cili kupton dhe ngushëllon me një energji rinore. Ai furnizon gjenitë

me zgjuarsi, ai mbush dhe u jep me tepricë gëzim dhe paqe të gjithë atyre që janë të etur për të.

Ai është Perëndia që përqafton me dashuri të shtypurit, të dobëtit, të pushtuarit dhe të pamundurit.

Ai është personi i vetëm që është gjithmonë pranë nesh, në dhimbjet tona dhe në tragjeditë që kalojmë në ditët e sotme.

Ai është Perëndia që kupton çdo njeri dhe çdo gjë si dhe ata që janë keqkuptuar nga të tjerët. Vetëm ai mund të depërtojë thellë në nevojat e njerëzve. Ai është Perëndia i njerëzve të shquar si: Shën Grigor Theologu, Shën Grigor Pallamai, Shën Kozmai i Etolisë, Shën Nektari etj.

Ai është Perëndia i cili, kur të na zbulohet "ballë për ballë", do të na habitë me madhësinë, fisnikërinë dhe kujdesin e tij Atëror.

Ai është Perëndi, i cili nuk e zbulon vetveten tek "të pamëkatshmit", "tek njëqind për qind të pastrit", sepse ata nuk ekzistojnë. Ai e zbulon vetveten tek mëkatarët, të cilët kërkojnë që Ta gjejnë, Ta njohin dhe kanë etje për Të. Ai e zbulon vetveten tek "kriminelët", "tagrambledhësit" dhe "prostitutat". Ai e zbulon veten e Tij tek artet e bukura, filmat, teatri, muzika, piktura, skulptura, poezia, letërsia, filozofia, shkenca, mendimi dhe tek të gjitha krijesat e universit. Kudo që njeriu përballet me probleme të jashtme ose të brendshme, Ai "vrapon" ta shpëtojë Ka ardhur koha të gjejmë Perëndinë e vërtetë, që ekziston si i Palinduri, që ka ekzistuar, ekziston dhe do të ekzistojë në jetë të jetëve.

Besimi i trashëguar

Udhërrëfimi kryesor që na ndihmon të gjejmë Perëndinë është besimi i trashëguar, i cili gjendet brenda çdo njeriu dhe nuk është një propagandë, siç mendojnë shumë njerëz.

Besimi në Perëndi është i mbjellë brenda çdo njeriu. Ai nuk është një shpikje e njeriut. Gjithashtu, nuk është as propagandë e as vjen si rezultat i frikës, sepse njeriu është imazhi i Perëndisë dhe "prototipi" sipas natyrës së Tij, pra është brenda natyrës së njeriut për të kërkuar Perëndinë. Kjo gjë është mjaft e dukshme duke parë shumë fakte dhe aspekte historike të jetës së tij shpirtërore.

Plutarku, një historian i hershëm, thekson se "qytete pa mure mbrojtëse, pa gjimnaze e pa shkolla mund të gjenden, por kurrë pa altarë dhe pa zot".

Psikologjia ka provuar se njerëzit lindin me një lloj tendence drejt së pafundmes, me fjalë të tjera drejt Hyjnore. Kjo është arsyeja që si njerëzit e dobët dhe fshatarët e paedukuar, ashtu edhe të fortët e të edukuarit, secili në mënyrën e vet, ndiejnë të njëjtën nevojë; të besojnë në një qenie më të lartë, në një fuqi më të madhe, në një realitet frymëzues, në të pafundmen. Tertuliani thotë se shpirti nga natyra është

kishtar, sepse përbëhet nga Zoti. Për këtë kërkon Zotin dhe e reflekton atë në shumë mënyra.

Të gjitha veprat e mëdha të njerëzve shprehin Hyjnoren.

Të gjitha qytetërimet e mëdha reflektojnë Hyjnoren

Që nga qytetërimi aziatik e deri tek qytetërimi evropian, përfshinin në zemrën e tyre Hyjnoren. Të gjitha këto praktikonin besimin. Piramidat, Parthenona në Akropol, shën Sofia, Tempujt e Indisë janë shprehje të njohura të qytetërimeve të mëdha.

Këto shprehje buruan dhe vazhdojnë të burojnë nga elementi hyjnor brenda njeriut. Megjithatë, njeriu nuk e shpreh vazhdimisht këtë element hyjnor, pasi mbulohet nga gabime të ndryshme të vetëdashjes.

Në mënyrë literale dhe te pjesët muzikore gjithmonë shprehet ndërjegjja fetare e qenies njerëzore.

Që nga Homeri e deri te Gëtja, nga Rumanoi, muzikanti e Joan Damaskinoi e deri tek Bethoveni, të gjitha këto pjesë shprehin Hyjnoren.

Edhe ata që kundërshtojnë Hyjnoren, ashtu siç e përmendëm edhe më sipër, të gjithë vërtiten rreth Hyjnores dhe e shprehin atë.

Qytetërimet nuk mund të ekzistojnë pa elementin Hyjnor, sepse me mungesën e këtij elementi qytetërimi humbet plotësisht. Edhe qytetërimi ynë rrezikohet të zhduket, pasi po shkon drejt turbullimit e kaosit.

Të gjitha këto provojnë se Hyjnorja nuk është një shpikje e njeriut, as një rezultat i frikës ose propagandës fetare. Siç e përmendëm, është e mbjellë brenda njeriut, sepse njeriu është imazhi i Perëndisë.

Hyjnia krijoi njeriun dhe jo njeriu hyjninë. Është e njëjta gjë për letërsinë, njeriu e krijoi atë dhe jo letërsia njeriun. Anijet ndërtohen, sepse ekziston deti, por deti nuk ekziston sepse ka anije.

Tani që origjina hyjnore e qenies njerëzore dhe besimi i trashëguar në Hyjnore është qartësuar, le të ndihemi të lirë të kërkojmë si dhe ku mund ta gjejmë Perëndinë e vërtetë. Por para se të vazhdojmë duhet të theksojmë pjesën kryesore dhe më të rëndësishme në Biblën e Shenjtë, ku thuhet: "Perëndia është Frymë dhe ata të cilët e lavdërojnë Atë duhet ta lavdërojnë në Frymë dhe të vërtetën" (Joani 4:21). Për këtë arsye ne duhet ta kërkojmë Atë në mënyrë shpirtërore, në mënyrë të thellë dhe jo sipërfaqësore e racionale.

Është mjaft karakteristike ajo çfarë thotë një fëmijë i vogël: "Kur vizatoj piktura të Perëndisë nuk e shtrëngoj shumë lapsin në letër, në mënyrë që Perëndia mos të duket shumë qartë pasi Ai është Frymë."

Dhe Fryma ka nevojë për një përpjekje shpirtërore, për një kërkim shpirtëror e një pamje shpirtërore. Kërkon perceptim.

Kërkimi

Për çdo gjë që ka vlerë është i domosdoshëm kërkimi. Edhe më shumë i vlefshëm bëhet në rastin kur ne duhet të gjejmë se cilat janë bazat e jetës sonë. Kërkimi për të gjetur Perëndinë e vërtetë si themelin e jetës sonë, kërkon një studim të thellë dhe të mundimshëm. Shprehja "Beso dhe mos heto" është një gabim i madh. Është një shpikje e njerëzve të ligj. Shën Joan Gojarti me autoritet qartëson këtë temë të rëndësishme dhe na shpjegon: "Mendja na urdhëron që të kërkojmë dhe të studiojmë besimin dhe jo ta lëmë atë të pashtjelluar." Në një vend tjetër shkruan: "Gërmoni thellë, në mënyrë të kujdesshme në Shkrime, që të mund të gjeni të vërtetën në tekste. Prandaj, kërkoni sidomos në thellësi, "gërmoni thellë". Gërmimi nuk duhet të jetë sipërfaqësor, nuk duhet të kërkoni vetëm në sipërfaqe për njohuri. Pra, gërmoni që të gjeni kuptimet më të thella dhe të vërteta.

Kjo është arsyeja që Perëndia na ka dhënë dhuratën më unike dhe të vetmen nga të gjitha krijesat e dukshme, dhuratën e të arsyetuarit, në mënyrë që të studiojmë gjithçka me imtësi. Logjika është mjeti, të cilin e përdorim për të kuptuar të gjitha aspektet e jetës sonë dhe të studiojmë gjërat sa më shumë të jetë e mundur.

Është mjeti, të cilin e drejtojmë lirisht kudo dhe kurdoherë që ne dëshirojmë. Gjithashtu logjika është një marrëdhënie, metodë, mjet dhe mënyrë. Padyshim që pa këto ne nuk mund të dalloheshim nga kafshët. Pa logjikën ne kurrë nuk do të mund të "gërmonim" thellë për të vërtetën. Por gjithashtu në këtë pikë duhet të jemi të kujdesshëm. Kjo pjesë, të cilën e quajmë logjikë, nuk përfshin të gjithë qenien tonë njerëzore. Nuk mund të arrijë kudo. Ka nevojë për ndihmës dhe për drejtim; ndihmësit dhe drejtuesit e saj janë intuita dhe besimi. Vetëm ato mund të na ndihmojnë "të mbajmë e të kuptojmë" çfarë është shpirti, sepse ato kapërcejnë logjikën tonë dhe mund të arrijnë gjithçka "përtej arsyes" dhe "përtej shqisave". Kur ato zhvillohen shikojnë substancën më të thellë të qenies.

Le të flasim edhe pak për marrëdhënien ndërmjet arsyes dhe besimit, arsyes dhe intuitës.

Arsyeja dhe besimi

“Perëndia i ka dhënë njohurinë njeriut, që nëpërmjet përdorimit të saj ai të mund të lëvdohet” (Urtësia e Jisuit, birit të Sirakut, 38:5).

Janë të shumta të Shenjtat dhe Misteret brenda njeriut dhe në univers, të cilat arsyeja nuk mund t'i kuptojë. Ato i përkasin vazhdimësisë së njeriut, gëzimit, intuitës, besimit të trashëguar, zbulesës dhe të vërtetës “negative”. Me fjalë të tjera ato i përkasin të vërtetës që kapërcen aspektet e arsyes; të vizionit, të diçkaje përtej mendjes së mbilogjikshme. Për këtë, arsyeja dhe besimi së bashku plotësojnë njeriun. Nëse do të ndajmë besimin nga arsyeja, ato do të shkatërrojnë njëra-tjetrën. Njëra nuk ka kuptim pa tjetrën. Njeriu është krijuar nga Krijuesi i tij me besimin dhe arsyen së bashku. Në të gjitha fushat e jetës së njeriut arsyeja dhe besimi duhet të bashkëpunojnë në harmoni, në mënyrë që të shmangin “shqetësimet”. Edhe matematika që është një shkencë e të menduarit, na bën që të përdorim arsyen dhe besimin së bashku.

Përtej kufijve të shkencës, fillon menjëherë misteri dhe e panjohura. Matematicieni i madh Poinkare, thotë në mënyrë karakteristike: “Bashkë me kufijtë e shkencës, flamuri i së panjohurës valvitet lart. Dhe sa

më shumë kufijtë zgjerohen, aq më shumë shpërndahet misteri”.

Shkenca në vetvete nuk mund të shpjegojë dhe t’i përgjigjet shumë pyetjeve si: Kush? Çfarë? Si?

Kush? Çfarë? Si?

Kush e krijoi universin? Kush e rregulloi lëvizjen e biliona yjeve dhe galaktikave në mënyrë që të mos përplasen me njëra-tjetrën? Kush e rregulloi qendrën pothuajse të padukshme të atomeve e të elektroneve, të cilat rrotullohen në masë të madhe dhe janë të vendosura në atë mënyrë sa që formojnë bazat dhe strukturën e universit?

Kush rregulloi që dielli të lëshojë mbi tokë aq energji diellore sa nevojitet? Dielli prodhon 6 milionë fuqi energji diellore në një minutë, e cila mund të digjte tokën nëse do të lëshohej e gjitha mbi sipërfaqen e saj.

Kush rregulloi në planetin tonë stinët e vitit, në mënyrë që të sigurohej zhvillimi i jetës në tokë? Kush rregulloi që nitrogjeni, oksigjeni, hidrogjeni dhe gazra të tjerë të jenë në sasinë e duhur për jetën në planetin tonë?

Kush rregulloi një funksionim shpirtëror dhe fizik të njeriut në atë mënyrë që të baraspeshohej e të arrijë vepra të mëdha?

Kush ia dha njeriut aftësinë e mrekullueshme të të arsyetuarit, duke ditur që edhe kafshët kanë tru, por nuk kanë intelektin ose ngjashmërinë mendore si të njeriut. Teoria e darvinistëve beson atë çfarë dhe vetë

Darvini ka pohuar; se ai vetëm bëri disa supozime; dhe se njeriu e ka prejardhjen nga majmuni është një teori e vjetëruar. Ajo është diskretituar si joshkencore në konferencën që u mbajt në Çikago, në dhjetor të vitit 1980, ku morën pjesë 160 paleontologë, gjeologë, biologë, embrologë dhe shkencëtarë të gjenetikës.

Këta shkencëtarë të specializuar, deklaruan se teoria e Darvinit dhe teori të tjera të ngjashme asnjëherë nuk janë provuar shkencërisht.

Kush harmonizoi variacionet e ngjyrave, formave, specieve dhe mbretërinë e kafshëve e të luleve? Nëse studiojmë çdo lloj dhe secilin prej aspekteve në veçanti, do të mahnitemi nga mënyra e mrekullueshme e përbërjes së tyre.

Volume të shumta mund të shkruhen në lidhje me këto pyetje Si? Çfarë? dhe Kush? rregulloi qeniet e mrekullueshme të universit si ato materiale dhe shpirtërore, e në mënyrë të veçantë njeriun. Sa më shumë që shkenca përparon, fakte të reja të mahnitshme dalin dhe ne zhytemi akoma më thellë në misteret frymëzuese. Çdo krijesë, që nga lulet e deri tek galaktikat e pafundme është një thirrje dhe një vend i fshehtë ku mund të gjendet Perëndia. Është një mënyrë e ekzistencës së Tij dhe shfaqjes në botë. Duhet që të keni sy të shikoni misteret e Perëndisë dhe veshë të dëgjoni se si Fjala e Pafund interpreton qëllimin dhe arsyen e ekzistencës së gjithçkaje. Fjala e Pafund përbën fuqinë e çdo krijese. "Ai tha dhe të gjitha u bënë".

Misteri më i madh

Perëndia në vetvete është misteri më i madh për njeriun. Perëndia është i pafund, jashtë kohe, i përjetshëm. Ai është jeta dhe e vërteta. E gjitha kjo është një mister dhe kërkon sy "jashtëkohor". Sy që mund të zhyten në mistere. Ato nuk mund të përfshihen me pamjen e përditshme dhe me formën e kufizuar të intelektit njerëzor. Ato kërkojnë besim. Nëpërmjet besimit misteret e qiellit dhe tokës vijnë më afër e bëhen pjesë e jetës sonë. Perëndia mund të jetohet brenda sekreteve të universit. Perëndia krijoi dhe bëri gjithçka prej hiçit. Pa Perëndinë që është i gjithëpushtetshëm, i gjithëfuqishëm dhe mëshirues, ekzistenca dhe struktura e universit nuk mund të interpretohen, e në mënyrë të veçantë ekzistenca e qenies njerëzore.

Pra, duke perceptuar urtësinë prej së cilës përbëhet krijesa, një njeri futet menjëherë në misterin e Krijuesit të padukshëm. Fenomeni i paimagjineshëm i universit material dhe shpirtëror na çon në ekstazë. Në këtë mënyrë kapërcejmë pamjen e zakonshme të qenies sonë dhe shkojmë drejt mbipamjes. Nga arsyeja ne kalojmë në mbiarsyen, në mister. E vetmja fuqi për të interpretuar në mënyrë të saktë ekzistencën tënde dhe atë të universit, është zbulimi i së vërtetës. Në këtë

moment kërkimi personal i Zbulimit të së Vërtetës të kërkohet, i cili mund të jetohet brenda misterit të Biblës së Shenjtë dhe Traditës së madhe të Kishës. Jashtë Biblës dhe traditës, e Vërteta e zbuluar, besimi i vërtetë në Perëndinë Triadik nuk ekziston. Brenda Kishës dhe kungimit të shenjtë, njeriu mund të shkëputet nga errësira dhe të gjejë të vërtetën, njohurinë e vërtetë, e cila është më e lartë se ndryshimet e vazhdueshme të njohurive të shkencës.

Ndryshimet e shkencës

Të njëjtët shkencëtarë rrëfejnë se ata nuk mund të shpjegojnë esencën e qenies ose esencën e pafundësisë, dritës, vendit, jetës, vdekjes, lirisë, ndërgjegjes e shumë fenomeneve të tjera. Ata i studiojnë të gjitha, por nuk mund të na thonë asgjë rreth esencës së tyre.

Baçer, një materialist i madh, në një moment singeriteti shprehet: "Ne nuk e njohim esencën e qenies në asnjë mënyrë".

Duke përdorur mjete të ndryshme, të cilat zotëron shkenca në periudha të ndryshme, ajo kërkon dhe bën zbulime të rëndësishme. Shpeshherë, rezultatet e konkluduara me mjete jo të plota, janë të gabuara. Për këtë arsye është e domosdoshme të hidhen poshtë konkluzionet dhe teoritë e mëparshme e të formulohen teori të tjera. Për shembull; në vitet e mëparshme shkenca pranoi teorinë se toka është e palëvizshme dhe dielli rrotullohet rreth saj. Më vonë, Galileo i përmbysi këto teori. Natyrisht që astronomët e lashtë grekë si Samio, Aristarkos e të tjerë, mbrojtën idenë se toka rrotullohet. Por, shkenca nuk e besoi këtë teori, pasi kërkonte "prova".

Në kohët e lashta, shkenca mendonte se atomi ishte një element i pandashëm, por tani atomi është shpërbërë me anë të mjeteve fizike nukleare. Gjithashtu mjekët në kohët e lashta operonin njerëzit pa përdorur mjete për t'u mbrojtur nga sëmundjet ngjitëse. Ishte Pasteri ai, i cili i udhëzoi shkencëtarët dhe i tha: "Mbroni veten tuaj kundër mikrobeve".

Dikur, mendimet e Aristotelit konsideroheshin të pandryshueshme. Më vonë u shfaqën Kartesiusi, Kanti, Hegeli, Haizembergu, Ainshtajni e shumë të tjerë, të cilët sfiduan mendimet e Aristotelit (sidomos pas nxjerrjes së teorisë së relativitetit).

Dhe ne akoma nuk e dimë se çfarë mund të sjellë e nesërmja. Nëse do të varemi nga përparimi i shkencës, duhet të jemi të sigurtë se studimet e shkencëtarëve të së nesërme do të na shfaqen me mjete të reja dhe do t'i japin më autoritet shkencës e do të flakin shumë nga faktet e sotme. Përparimi i vërtetë i shkencës është ai i cili në të ardhmen nuk do të hedhë poshtë shumë nga teoritë e sotme, si supozimet e krijimit të universit, të cilat janë mohuar me kalimin e kohës.

Njohuritë e shkencës janë në ndryshim dhe qëndrimet dogmatike në shkencë janë të papranueshme. Kjo është arsyeja që njeriu nuk duhet të varet absolutisht nga ndryshimet e shkencës. Pra, është e shpjegueshme arsyeja që disa nga shkencëtarët më të mëdhenj nga fusha të ndryshme të shkencës nuk u varën plotësisht nga njohuritë shkencore, por vazhduan në besim dhe në njohuritë nëpërmjet

zbulesës, atje ku mund të gjenin Perëndinë. Vetëm duke u futur brenda e në thellësi të Mbilogjikës ata mund të interpretojnë gjithçka.

Mbilogjika

Besimi nuk është irracional, por shkon tej arsyes. Irracionalja është diçka inferiore, nuk bazohet asgjëkundi dhe është e paorganizuar. Besimi qëndron më lart se arsyeja, është më superior. Është urtësia që kalon shqisat e njerëzve dhe arrin sekretet e jetës dhe të vdekjes, të universit e pafundësisë. Nëpërmjet besimit Perëndia i pafund mund të gjendet. Nëse Perëndia do të dorëzohej në format e ndryshme të arsyes njerëzore dhe krijimit të shkencës, atëherë nuk mund të ishte Perëndi i pafund. Ai do të ishte si ne dhe si rrjedhojë do të ishte një krijim yni, më inferior se ne. Ndërkohë, Perëndia është shumë më i lartë dhe më superior se ne. Ai është mbi ne dhe jo nën ne. Kjo është arsyeja pse ne nuk mund të kuptojmë fillimin dhe esencën e Tij e të mund ta shprehim atë.

Kisha, në një nga uratat e saj thotë: "Sepse ti je Perëndia i papërshkrueshëm, i panjohur, i padukshëm, i pakuptueshëm, i përjetshëm". Megjithë faktin që ne nuk mund ta shprehim Atë dhe mendja jonë s'mund ta mbajë dot, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston. Fakti që nuk mund të fusim të gjithë oqeanin në një gotë, nuk do të thotë që oqeani nuk ekziston.

Perëndia gjendet përtej "gotës" së njohurisë njerëzore, si dhe mbi eksperimentet shkencore të njerëzve. Ai gjendet tek besimi, i cili nuk vihet në provë. Ai gjendet në misterin brenda nesh, në të pafundmen. Në këtë pikë duhet të sqarojmë diçka mjaft të rëndësishme në lidhje me "provat". Për sa i përket ekzistencës së Perëndisë, një besimtar nuk mund të japë "prova" shkencore tek një ateist në mënyrë që ta bindë atë se Perëndia ekziston. Në të njëjtën mënyrë edhe ateisti nuk mund të gjejë prova për të bindur besimtarin që Perëndia nuk ekziston.

Besimtari, në krahasim me ateistin, ka një avantazh të madh, pasi mund t'i paraqesë ateistit probleme të shumta thjesht duke i bërë pyetje të tilla: Si u krijua nga hiçi një univers i tillë i mahnitshëm dhe si mbështetet dhe udhëhiqet? Përveç kësaj, teoria e ekzistencës së përjetshme të materies së universit në ditët e sotme është vënë në dyshim edhe nga vetë shkenca. Teoria e Lavoisierit rreth paprishjes së materies, pothuajse është mohuar nga vetë shkenca. Materia është e degradueshme. Ashtu si dhe shkenca pohon, mund të degradohet nga vdekja. Si është e mundur që një qenie joekzistuese, që është diçka abstrakte dhe pa substancë mund të interpretojë faktet e pashpjegueshme të krijimit të universit, e për më tepër kërkon të shpjegojë fillimin ose origjinën e krijimit?

Gjithashtu mund të pyesni se si bimët e kafshët u krijuan dhe sidomos qenia që quhet njeri?

Origjina e krijimit

Në fillim të këtij studimi thamë se materialistët besonin se universi ekzistonte më parë dhe u shfaq e filloi të zhvillohej vetë. Por, asnjë person nuk mund t'i konfirmojë këto teori shkencërisht.

Kërkimet shkencore (sidomos teoria dominuese kozmologjike e Big Bangut) mund të shpjegojnë shumë rreth zhvillimit të universit, domethënë, se si ishte përbërja e atomit të parë, matjen e temperaturës dhe si ndryshonte. Por kjo teori ndalonte përpara misterit të Origjinës së Parë dhe e quante atë "Pika josimetrike". Kjo "pikë josimetrike", fillimi i parë i universit, është një faktor i panjohur për shkencën, sepse i përket misterit të krijesisë të pafund, i cili është i paarritshëm për mendjen e kufizuar të qenies njerëzore.

Pra, shkencëtarë jo të sinqertë dhe të papërgjegjshëm mundohen të na provojnë se universi ekzistonte më përpara e u shfaq nga vetvetja. Në të kundërt, shumë studiues të famshëm, besojnë dhe pohojnë se Krijuesi i universit është i Pakuptueshmi, Perëndia i Pafund. Me Atë, nëpërmjet Intuitës, Zbulesës, së Vërtetës e Besimit, ata interpretojnë çdo gjë që përbën racionalen dhe irracionalen e Krijimit.

Dhe tani le të shohim se kush e gjen Perëndinë e Pakuptueshëm?

Kush e gjen Atë?

Gjëja e parë e qartë që duhet të pohojmë, është se qytetërimet tona bashkëkohore, të cilat janë të qeverisura nga materializmi, tirania, racionalizmi e në shumë vende nga dhuna, as që e mendojnë të kërkojnë Perëndinë. Thënia më e spikatur në ditët e sotme është: "Lërna të hamë e të pimë, se nesër do të vdesim". Kjo gjurmon dhe kërkon atë që është më e lehtë për t'u bërë dhe kënaqësinë e jetës së përditshme. Për sa i përket Perëndisë dhe shpirtit, qëndrojnë indiferentë.

Rinia e sotme ndikohet më shumë nga lëvizje të ndyshme, të cilat luftojnë e thërrasin për drejtësi, ushqim, liri politike, zhdukjen e testeve nukleare, çarmatosjen, zvogëlimin e ndotjes së ambientit, lirinë e marrëdhënieve seksuale e shumë probleme të tjera. Në mes të gjithë këtij kaosi, si mund të mendoni për Perëndinë e vërtetë e të kërkonit ta gjeni Atë? A mundet që një kërkim i tillë të jetë i pavend? A mund të jetë thjesht një veprim nxitës?

Të gjitha këto kërkime e lëvizje sociale (socialistët, ekzistencialistët madje dhe anarkistët), në thellësi shprehin etjen për Perëndinë e Vërtetë. Duke kërkuar për drejtësi, të vërtetën, dashurinë, paqen, lirinë, lumturinë, në fakt ata kërkojnë për Perëndinë, pasi Ai

është burimi i të gjitha këtyre gjërave. Megjithëse luftojnë kundër Perëndisë, ata e kërkojnë Atë.

Në ditët e sotme, Perëndia gjendet në të gjitha këto lëvizje, madje edhe në ato më ekstremistet. Bota ku jetojmë, e sidomos të rinjtë, me të gjitha lëvizjet paqësore ose revolucionare, përpiqen që të kënaqin etjen e tyre metafizike. Njerëzit përpiqen që të gjejnë të vërtetën, absoluten, të përkryerën. Ata nuk dinë ku dhe si ta gjejnë, kështu që çorientohen plotësisht. Duke vënë në qendër të tyre iluzionet, ata bëhen edhe më konfuzë.

Megjithatë, etja e tyre mbetet e pashuar dhe me kalimin e kohës bëhet më e madhe. Këto gjëra bëhen evidente nga një studim i thellë e i detajuar i problemit, ku gjërat janë analizuar në mënyrë të saktë dhe në esencën e tyre. Ajo që duhet thënë në një moment të tillë është: Njerëzit e sinqertë, ata të cilët janë të ndershëm e të përvuilur në mendje e shpirt, e jo egoistë e të këqij dhe që mendojnë se i dinë të gjitha, e gjejnë Perëndinë e vërtetë. Është e pamundur për njerëzit e këqij të shikojnë Perëndinë.

Të gjithë mund ta gjejnë Perëndinë, nëse nuk i japin prioritet egos së tyre dhe zhvillimit teknik të qytetërimeve, por përdorin shkencën e artin për të shprehur dashuri, të vërtetën e lirinë. Që të njohim vetveten, duhet të arrijmë një moral të lartë e të pushtojnë universin brenda nesh. Ata që japin dashuri pa pushim e pa vënë kushte, mund ta gjejnë Atë. Ata që sakrifikojnë veten e tyre për të tjerët dhe ndajnë në

mënyrë të sinqertë dhimbjen e gëzimin e tyre. Ata që edhe armiqtë e tyre i mendojnë e i ndiejnë të gjithë si vëllezër. Ata që duan me pasion jo vetëm lirinë e tyre, por edhe të të tjerëve. Ata, të cilët nuk shkelin kufijtë e lirisë së tyre për t'u bërë skllav i të tjerëve. Ata që janë pastruar nga pasionet. Ata që nuk janë dembelë. Ata, të cilët janë vazhdimisht të rilindur nga e vërteta. Ata që nuk kanë nevojë të përdorin maska për të mbuluar pikëpamjet dhe qëllimet e tyre. Në çfarëdo lloji mënyre këta njerëz e gjejnë Perëndinë e vërtetë. Fatkeqësisht, biliona perëndi zëvendësuese janë shfaqur gjatë shekujve të fundit. Këta janë "idhujt" e besimet pagane, magjistarët e profetët, si dhe ekstremet filozofike rreth Perëndisë. Këto janë të gjitha llojet e herezive, të cilat kanë keqtrajtuar dhe akoma vazhdojnë të keqtrajtojnë Perëndinë e vërtetë. Perëndia i vërtetë është shfaqur tek ne nëpërmjet Fjalës së Mishëruar, Krishtit, i cili është Perëndia personal i Trinisë.

Perëndia është personal

Duhet të bëjmë të qartë se Perëndia nuk është armiqësor, nuk është një qenie abstrakte, jo e qartë, siç është parë nga shumë ndjekës të Pitagorës, Platonit, Orfeas e shumë Hinduistëve nga Perëndimi ose Lindja si dhe sisteme të filozofisë Budiste.

Perëndia është një qenie personale dhe vepron në mënyrë personale. Perëndia është Trinia e njëqenëshme, Ati, Biri e Shpirti i Shenjtë, që krijoi dhe drejton botën. Megjithatë, ne nuk mund të shpjegojmë në mënyrë korrekte drejtimin e Tij perfekt, sepse ne kemi një shikim të kufizuar e sa herë që shikojmë kontradikta, mendojmë se Ai është duke "fjetur". Vetëm një Perëndi personal mund të krijojë qenie si raca njerëzore.

Fytyra e njeriut, përfaqëson fytyrën e Perëndisë, presupozon Krijuesin. Perëndia pa fytyrë është i paimagjinueshëm. Perëndia Triadik shfaqet ndër ne, jo nëpërmjet substancës së Tij, por nëpërmjet veprimeve të Tij, Dashurisë së pakufizuar, Pagabueshmërisë, Fuqisë, e për më shumë me mirësinë e Tij, të cilat kanë hyrë në faqet e historisë në mënyrë personale. Erdhi në botë "në kohë e vend", pikësëpari me mishërimin e Fjalës, Krishtit, e më pas me zbritjen e Shpirtit të Shenjtë,

fytyra e tretë e Perëndisë Triadik në ditën e Pentikostisë. Erdhi dhe foli personalisht me njeriun.

Pra, Perëndia Trinitar, që bën të ligjshëm krijimin dhe drejtimin e Kishës, merr dhe transformon botën në mënyrë personale. Të tre personat e Trinitisë së Shenjtë, gjatë gjithë kohës kanë kontakt personal me veten e tyre, krijimin dhe historinë e botës.

Tani le të shikojnë në mënyrë më specifike se ku ndodhet Perëndia Triadik, Perëndia i vërtetë.

Ku mund të gjendet Perëndia i vërtetë?

Perëndia i vërtetë gjendet në krahët e gjithë krijimit. Në luftën për të pushtuar të vërtetën, dashurinë dhe lirinë. Në punën e rëndë, në luftën për jetën e përditshme. Në agoninë e kopshtit të Gjethsemanisë dhe në gëzimin e kopshtit të Ngjalljes. Në hidhërimin e mëkatit. Në vetënjohjen. Në lotët që shoqërojnë pendimin. Në ngritjen për të arritur Perëndinë. Në misteret e pafundme të Kishës. Me Kishën nuk nënkuptojmë vetëm ndërtesat e ritualet, as vetëm klerikët, por Jetën dhe të Vërtetën. Prandaj, duhet të kuptojmë që Perëndia nuk mund të gjendet në format e dështuara të racionalizmit të qytetërimeve bashkëkohore dhe teologjinë shkencore të perëndimit, as në hipokrizinë dhe hipotezat morale, të cilat nuk janë provuar kurrë, as në besimet fanatike e në besëtytni.

Perëndia gjendet në shpirtin e së vërtetës, sepse Perëndia është e vërteta. Perëndia gjendet në shpirtin e doktrinës ose besimin e vërtetë. Perëndia gjendet në përvojën personale që kemi me Të, thellë në misteret e pafundme dhe të përjetshme.

Çdokush që dëshiron të përgjigjet në mënyrë të saktë për ekzistencën e Perëndisë, në radhë të parë duhet të

bëjë një jetë të ndershme, duhet të rilindet nga Shpirti i Shenjtë dhe më pas të rrëfejë besimin tek Ai. Duhet të përsërisim se Perëndia është një përvojë personale në jetë. Nuk është një provë matematike dhe kjo është arsyeja që nuk mund të provohet me evidencat shkencore.

Perëndia nuk ndodhet në format racionale të krijuara prej nesh. Perëndia është i pafund dhe pafundësia nuk mund të ngatërrohet kudo.

Perëndia gjendet me këdo që përballet me dritën dhe errësirën, me gënjeshtrenë dhe të vërtetën, me asgjënë dhe të pafundmen, me dashurinë dhe urrejtjen, me skllavërinë dhe lirinë, me mishin dhe shpirtin, me sakrificën dhe egoizmin. Perëndia ekziston dhe i jep dritë cilitdo që vjen në botë. Megjithatë, i verbri nuk mund ta shohë. Nëse vendosni diçka para syve të një të verbri, ai nuk mund ta shikojë, sepse e ka humbur dritën e syve. Në këtë rast nuk është drita që duhet mallkuar, por dëmtimi i syve. Pra, besimi në Perëndi varet nga potenciali i njeriut për të kuptuar dritën hyjnore, e cila shpërndahet nëpërmjet besimit, që nga gjithë krijimi e sidomos nga struktura shpirtërore e njeriut, i cili është imazhi i Perëndisë.

“Është e pamundur që Perëndia të mos ekzistojë, - thotë Berdajev, - përderisa qenia e mrekullueshme, e quajtur njeri, ekziston dhe mban në çdo moment imazhin e Perëndisë së bashku me vet Krijuesin”.

Po, Perëndia ndodhet brenda nesh. Ne e shprehim atë, me ndërgjegje ose pa ndërgjegje, derisa kemi sytë

të hapur të shohim, derisa kërkojmë për esencën në sipërfaqe. Që të shohin në thellësi të vetvetes, në një mënyrë ose tjetër, njerëzit thërrasin dhe kërkojnë Perëndinë. Sepse, kur njeriu është i etur për absoluten, të përjetshmen, të përkryerën, kërkon në esencë Perëndinë, që është burimi i të gjithave.

Të gjitha këto që u përmendën përcaktojnë të drejtën, personin e kulturuar. Sa më shumë njeriu kultivohet nga ana shpirtërore, aq më shumë kërkon Perëndinë. Kërkon Perëndinë e vërtetë, i cili frymëzon dhe drejton njeriun drejt arritjeve të reja shpirtërore, përtej kohës dhe hapësirës duke arritur përjetësinë e pafundme, për të cilën është krijuar. Perëndia dhe njeriu "mbajnë" njëri-tjetrin në thellësi dhe në sasi. Kjo e fundit është lavdia e pafund, e cila arrihet vetëm prej atyre, të cilët mund të shohin përtej kohës.

Është e nevojshme për ne të hapim sytë tanë

Pra, ekziston një nevojë urgjente që ne të hapim sytë tanë që të mund të shohim dritën e vërtetë, përtej racionalizmit tonë, përtej vetes sonë egocentrike. Në të kundërt, shumë shpejt do të drejtohem drejt kaosit. Natyrisht, këto gjëra nuk thuhën për të trembur njerëzit. Perëndia nuk dëshiron që njerëzit të afrohen tek Ai nga frika. Por ky është realiteti, të cilin e jetojmë çdo ditë, është zëri i historisë.

Nëse do të vazhdojmë të nxjerrim Perëndinë jashtë jetës sonë, nuk ka asnjë gjë që mund të na mbajë larg shkatërrimit. Nëse Perëndia nuk ekziston, atëherë çdo gjë është e lejueshme, ashtu si dhe Dostojevski shkroi, edhe "krimet më të llahtarshme". Jeta do të kthehej në mizerje. Vetëm Perëndia si arsyeja më supreme e jetës sonë, mund të na frymëzojë dhe të na ngrejë lart tek gjërat hyjnore, për të cilat jemi krijuar. Ai do të na çlirojë nga faji, frika, agonia dhe monotonia. Shkencat, artet, qytetërimet pa Perëndinë nuk mund të na japin gjëra hyjnore, kultura hyjnore, të cilat nevojiten për të mbushur skutat bosh të thellësive të esencës sonë shpirtërore. Kur shkencat dhe artet ndahen nga kultura hyjnore, fuqia e tyre shkatërrohet dhe shkatërron. Kjo është provuar tek ne në një formë tragjike gjatë dy

luftërave botërore. Njerëzit përdorin çfarëdolloj mjeti shkencor dhe teknologjik për të shkatërruar botën. Mjerë ne, nëse do të bëhet një luftë e tretë botërore.

Në ditët e sotme ne nuk jemi të lumtur, sepse jemi të shkëputur nga burimi i së vërtetës, lirisë dhe dashurisë, i cili nuk është tjetër veçse Perëndia Triadik. Ka ardhur ora, ku ne duhet të hapim sytë për të kapërcyer dritën e shkencës dhe të artit e të arrijmë Dritën Hyjnore, e cila mund të transformojë të gjithë universin tonë. Kjo është nevoja më urgjente, sidomos për të rinjtë.

Për të rinjtë

Përpara se ta mbyll këtë studim, dua t'ju drejtohem juve të dashur të rinj. Ju jeni pranvera e jetës. Shumë gjëra ju rrethojnë, disa janë të mira, disa të këqija. Përpara jush rrugë të reja hapen. Çdo moment ju do të dëgjoni teori të reja në lidhje me problemet e mëdha të jetës dhe të botës. Është e natyrshme që ju të dëgjoni ide të shumta e sidomos rreth temës kryesore, ekzistencës së Perëndisë.

Shumë njerëz në ditët e sotme duan të portretizojnë veten e tyre si ateistë, duke menduar se janë të modës. Ata mbështeten në shkencë për të provuar idetë e tyre e sidomos tek shkenca e fizikës. Fatkeqësisht, ata janë trupërisht të pavërtetë. Ata mundohen që t'ju zënë në grackë, në një kurth ku kanë rënë vet. Asnjë fizikant i madh i shekullit tonë nuk ka dyshuar për ekzistencën e Perëndisë. Maks Plan, Heizenberg, Van Braun, Kompton, Markon, Millikan, Ainshtajn e shumë të tjerë pohojnë qartë besimin e tyre në Perëndi, në Krijuesin e universit.

Shkenca e vërtetë e respekton Perëndinë, shikon qiellin me yje dhe mahnitet, shikon brenda madhësisë së shpirtit të ekzistencës njerëzore dhe befasohet.

Shikon mrekullinë e krijimit e ngre shpirtin tek Krijuesi Hyjnor dhe lutet. Shikon e dëgjon zbulesën e Krishtit Perëndi në historinë e botës dhe ndodhet në ekstazë. I ndihmuar nga kjo zbulesë arrin në thellësi të qenies dhe transformohet. Një person vërtet i edukuar jeton pa frikë brenda misterit të besimit. Ai jeton brenda madhësisë së dashurisë së tij. Me anë të këtyre dy krahëve, Besimit dhe Shkencës, ai ngjitet lart drejt lartësive hyjnore për të cilat është krijuar.

Ndërsa të tjerët, të cilët kanë luajtur rolin e ateistit dhe kanë portretizuar veten e tyre si persona të famshëm, në ditët e sotme kanë arritur në një fund të vdekur dhe në një udhë të errët. Qëndrimet dhe puna e tyre janë dëshmitarët më të mirë. Ata përpiqen që të gjejnë zgjidhje zëvendësuese për çështjet ontologjike, të ekzistencës, si dhe të metafizikës, e për këtë dështojnë. Zgjidhjet zëvendësuese nuk janë kurrë të vërteta. Ato shkatërrojnë, sepse nuk janë të orientuara drejt.

E vërteta është vetëm Perëndia i vërtetë. Ai iu dha njerëzve shkencën dhe zbulesën. Kjo është arsyeja që Ai ka pushtuar këto dy krahë, shkencën e vërtetë dhe zbulesën e vërtetë, sepse e drejton veten e tij në lartësitë e pafund, sidomos për ata që jetojnë një jetë të vërtetë.

E ardhmja e botës i përket së vërtetës, e cila përfaqësohet nga Krishti dhe njerëzit e vërtetë, të cilët janë të mbushur me besim. Krishti, e ardhmja dhe e vërteta janë një dhe e njëjta. Ju do të ndiheni të lumtur, nëse edhe ju do të bashkoheni më Këto.

Mesazh për lexuesin

Miku im, deri në këtë pikë e kam adresuar veten time tek intelekti juaj. Ne kemi komunikuar nëpërmjet mendjes. E kam lënë për në fund gjuhën e zemrës, të cilën e quaj pikën më të fortë. Ja pse dëshiroj që në fund të këtyre rreshtave të diskutojmë me zemër. Kam nevojë t'ju tregoj çfarë ndiej në zemrën time dhe çfarë kam fituar pas një lufte vigjilente e të gjatë.

Pas këtyre rreshtave të shkruara me përlulesi rreth ekzistencës së Perëndisë, si rezultat i mendjes njerëzore dhe të vërtetës së zbuluar, besoj se nuk ngelet gjë tjetër përveç se të pranojmë një nga dy interpretimet e mëposhtme:

Ky univers i mrekullueshëm në të cilin jetojmë, u mboll, u mirëmbajt dhe u ofrua rastësisht pa një kuptim dhe një qëllim e si rrjedhojë nuk ka Krijues.

Ose, këto krijesa madhështore, të dukshme e të padukshme ku ne jetojmë, bashkë me botën e madhe shpirtërore, erdhën në ekzistencë nga asgjëja nëpërmjet një Krijuesi – Perëndi, që është i gjithëpushtetshëm, i gjithëfuqishëm dhe mëshirues, i cili shfaq çdo gjë, i drejton të gjitha dhe shpjegon të gjitha.

Shpirti dhe zemra ime është dakord me Ainshtajnin, i cili thotë: "Është e pamundur për Perëndinë të luajë

kumar kur Ai e krijoi botën” dhe si rezultat mohon interpretimin e parë të rastësisë, duke e cilësuar qesharake dhe të papranueshme nga çdo mendim njerëzor.

Ata pranojnë interpretimin e dytë, të besimit në Perëndi, Krijuesin dhe Udhëheqësin, i cili krijoi universin nga asgjëja. Edhe pse nuk mund të gjej Fillimin e pafund të tij, sepse si një nga krijesat e tij është e pamundur të vë veten time para Fillimit të krijimit dhe Krijuesit e ta kritikoj atë, për mua është e mjaftueshme që unë jetoj në Atë. Pra, besimi në Krijuesin-Perëndi dhe Udhëheqësin e vërtetë më mbush me gëzim dhe dritë. Dëbon larg agoninë e tmerrit, frikën e së panjohurës dhe tragjedinë e kaosit e të hiçit. Më dhuron çfarëdolloj gjëje që është e çmueshme e fisnike dhe thëllon kuptimin e ekzistencës sime. Nuk më lë në dorë të rastësisë. Më jep kuptim dhe më udhëheq drejt Hyjnore. Më jep atë çfarë është mbjellë thëllë në shpirtin tim: Jetën Hyjnore.

Prandaj, a do të ishte propagandë ose e pamend, nëse do t’ju rekomandoja juve të dashurve të mi të shijoni, nëse akoma nuk e keni bërë, shijen e besimit në Perëndinë e vërtetë dhe të shikoni se çfarë të dhuron e çfarë horizontesh të mrekullueshme e të pafundme do t’ju hapen?

Unë besoj, se një person i lirë dhe që nuk ndikohet, do ta provonte atë.

Më tej unë besoj, se asnjë eksperiencë nuk është më e madhe dhe më e fuqishme sesa besimi në Perëndi,

sepse Perëndia është jeta, fuqia, gëzimi, drita dhe lumturia, për të cilat çdo person i sinqertë ka etje. Është jeta e jetës. Është gjithçka. Ja pse Homeri shkroi: "Të gjithë njerëzit dëshirojnë Perëndinë", me fjalë të tjera të gjithë njerëzit kanë nevojë për Perëndinë e Hyjnoren, ashtu siç dikush tjetër tha: "Tërë jetën time derisa të jetoj, të marr frymë e të mendoj, kurrë nuk do të ndaloj së thururi himne lavdërimi, ty, o Krishti im".

Nëse dëshiron, përpiqu edhe ti, e do të bindesh ashtu si shumë të tjerë janë bindur gjatë shekujve; turma të mëdha njerëzish të vërtetë, të cilët nuk besuan në gjëra të copëtuara dhe nuk jetuan rastësisht, por përqaftuan të Vërtetën, Mbilogjokën, Fjalën, Perëndinë.

Besimi në Perëndi nuk është çështje e nivelit të edukimit, por është çështje e të menduarit korrekt, e gjykimit të drejtë. Është një çështje e Misterit. Është një çështje e përvojës personale në jetë. Është një çështje e marrëdhënies personale me të Vërtetën.

Perëndia përjetohet dhe nuk është një çështje diskutimi e as një temë që duhet të analizohet. Në të kundërt do të ishte një kufizim njerëzor. Perëndia është shfaqur dhe është një përvojë personale e dhimbjes, gëzimit, lumturisë, dashurisë, të cilat çdo njeri mund t'i jetojë brenda shpirtit të tij.

Cilido që ndjen flladin e natyrës, dallgët e oqeanit, këngën e gjinkallës, fluturimin e bletës nga një lule tek një tjetër dhe shikon universin e brendshëm dhe të jashtëm të tij e ka dëshirë e jeton me të vërtetën, si një njeri i vërtetë, ai dëgjon dhe shikon Perëndinë. Ai e

kupton Perëndinë pa pasur nevojë të ketë prova, ashtu si nuk ka nevojë të vërë në provë lumturinë që shtrihet thellë në qenien e tij.

Vetëm budallenjtë dhe të ngathtit nuk mund të shohin Perëndinë e ta kuptojnë Atë. "Dhe budallai tha në zemrën e tij: nuk ka Perëndi".

E mbi të gjitha Perëndia është Jeta dhe Ringjallja, është fundi i së pafundmes, e pathëna me të cilën jeton, por të cilën nuk mund ta përshkruash për shkak të arsyes së kufizuar. Është Krishti i Abrahamit, i Isakut dhe Jakovit, është Krishti i profetëve dhe i bijve të Izraelit, Krishti historik i Dhiatës së Re, të cilin Kisha e përjeton nëpërmjet Mistereve të mbinatyrshme.

Ky është Perëndia i cili kujtohet çdo ditë, por nuk arrihet asnjëherë. Ai nuk mund të kuptohet nëpërmjet matematikës e nga sistemet e format racionale të jetës sonë.

Sepse Perëndia është Besim, lavdërohet dhe nuk mund të mësohet.

Ky pohim bëhet i qartë nga rrëfimet e mëposhtme.

Rrëfime të rëndësishme

SHËN PAVLI:

“Çdo shtëpi ka themeluesin e saj; dhe themeluesi i të gjithave është Perëndia” (Hebrenjve 3:4).

LEXIM GJATË PASHKËS

Vetëm Krishti mund të zgjidhë dramën njerëzore. Skutat e thella të shpirtit mund të mbushen vetëm nga Perëndia. Nuk ka asgjë të mirë larg Perëndisë. Zemra e njeriut nuk mund të mbushet derisa të arrijë fronin e Perëndisë, asnjë nuk mund të jetë i lumtur si i krishteri i vërtetë. Pa Krishtin dhe Shkrimet e Tij ne nuk mund të dimë asgjë në mënyrë të saktë. Ne qëndrojmë në errësirë dhe të ngatërruar.

Njerëz, ju kërkoni lumturinë tuaj në humbëtirën e vetes suaj, larg Perëndisë. Arroganca juaj nuk ju lejon të besoni në Zot. Juve nuk ju mungojnë provat për të besuar në Zot, juve ju mungon zemra e pastër. Kthehuni tek Krishti e do të shpëtoheni.

AINSHTAJN:

“Shkenca pa Perëndinë është e kotë”.

JUNG:

“Perëndia është brenda nesh. Të gjitha aspiratat e njeriut drejtohen tek Perëndia. Shpirti nga natyra drejtohet tek Hyjnorja”.

ADLER:

“Perëndia është kulmi i njeriut”.

PASTER:

“I lutem Perëndisë gjatë punës sime në laborator”.

BAH i drejtohet gruas së tij në momentet e fundit të jetës:

“Magdalenë, ku po shkoj, dëgjoj një muzikë, të cilën ti dhe unë vetëm mund ta kemi ëndërruar dhe sytë e mi do të shohin vetë Perëndinë”.

DEKARTI:

“Nëse ka akoma persona të cilët nuk janë të bindur për ekzistencën e Perëndisë, le ta dinë se gjithë gjërat e tjera, për të cilat mendojnë se janë më të sigurta, siç mendojnë se kanë një trup e toka ekziston, e yjet e të tjerat, janë më pak të sigurta”.

GËTE:

“Të gjitha gjërat janë krijuar nga dora dhe dëshira e Perëndisë”.

DOSTOJEVSKI:

“Duhet të keni besim të plotë në Perëndinë”.

DARVINI:

“Evolucioni është rezultat i ligjeve, të cilat Krijuesi i vendosi në natyrë. Mendjet më të mëdha që kanë jetuar gjatë shekujve i janë përgjigjur ‘po’ pyetjes nëse ekziston një Krijues dhe Udhëheqës i universit”.

VOLTERI (armik i Krishterimit):

“Bota më ngatërron mua, sepse unë nuk mund të pranoj se kjo orë punon pa e krijuar dikush”.

DIDEROI (mohues i Perëndisë):

“Sytë dhe krahët e një fluturë (të cilat janë krijuar me kaq urtësi mahnitëse e në mënyrë artizanale) mjaftojnë për ta shkatërruar një ateist”.

SOLOMONI:

“Të gjitha gjërat flasin për Perëndinë”.

NIÇE

(Lufta e tij tragjike)

Perëndi, kthehu

*Me jep dashuri! Kush po më ngroh
akoma?*

Kush më do akoma?

Më jep duar të ngrohta.

Më jep rrahjen e ndritshme të zemrës.

Jepmë, dorëzo tek unë veten tënde?...

Largohu! Pastaj ai u largua.

Miku im i vetëm.

Armiku im i madh.

I panjohuri im.

Vrasësi im-perëndi!...

Jo! Kthehu. Të gjithë po vuajmë.

Lotët e mi po derdhen pas teje, drejt teje.

Dhe drejt teje shkëndija e fundit e zemrës po

ngjitet. Oh, kthehu Perëndia im i panjohur,

rënkimi dhe dhimbja ime, lumturia ime e

fundit...



PO, PERËNDIA EKZISTON

"Sepse në të ne jetojmë, lëvizim dhe jemi".

SHËN PAVLI (Veprat 17:28)

"Ekziston një Perëndi, që i sheh të gjitha, mendon për gjithçka, i dëgjon të gjitha".

KSENOFANI (Filozof i shek. VI para Krishtit)

- **K**ushdo që jeton me Perëndinë, jeton përjetësisht pafundësinë e universit. Ai përjeton Fjalën e Pafundme.
- **A**snjë person i kujdesshëm dhe mendimtar nuk e ka mohuar kurrë Perëndinë.
- **A**snjë person mendjelehtë nuk e shikon Perëndinë.
- **K**ërkoni dhe do ta gjeni Perëndinë. Vetëm kini kujdes si dhe ku të kërkoni. Perëndia gjendet në natyrë dhe në Kishë.
- **M**os flisni shumë tek njerëzit rreth Perëndisë. I flisni më shumë Perëndisë rreth njerëzve.
- **A** e keni kuptuar që Perëndia është një çështje personale për ju?
- **P**erëndia nuk dëshiron që të na detyrojë, por kërkon të bashkëpunojë me ne. Perëndia respekton lirinë tonë.

PËRMBAJTJA

A ekziston Perëndia?	3
Pyetja e madhe	5
Kush pranon ekzistencën e Perëndisë dhe si?	11
Këndvështrimi	15
Dy aspektet	17
Perëndia i harruar	19
Perëndia i vërtetë	20
Besimi i trashëguar	22
Të gjitha qytetërimet e mëdha reflektojnë Hyjnoren	24
Kërkimi	26
Arsyeja dhe besimi	28
Kush? Çfarë? Si?	30
Misteri më i madh	32
Ndryshimet e shkencës	34
Mbilogjika	37
Origjina e krijimit	39
Kush e gjen Atë?	40
Perëndia është personal	43
Ku mund të gjendet Perëndia i vërtetë?	45
Është e nevojshme për ne të hapim sytë tanë	48
Për të rinjtë	50
Mesazh për lexuesin	52
Rrëfime të rëndësishme	56